



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 30, datë 09. 10. 2012

PËR

“NJË NDRYSHIM (SHITESË) NË RRJETIN E LINJAVE QYTETËSE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 25, DATË 16.05.2006 MBI “PËRCAKTIMIN E LINJAVE TË TRANSPORTIT QYTETËS TË UDHËTARËVE, MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË SHËRBIMIT DHE RIPËRCAKTIMI I STACIONEVE TË QËNDRIMIT TË AUTOBUSËVE TË SHËRBIMIT NË KËTO LINJA” (I NDRYSHUAR)”

Në zbatim të nenit 10/3/I, shkronja “d” dhe nenit 32, shkronja “k” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neni 128 i ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar); ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); neni 14 të ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 për “Transportet Rrugore” (i ndryshuar); udhëzimit nr.15 datë 24.7.2007 për “Kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Në pikën 1 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 16.05.2006 mbi “Përcaktimin e linjave të transportit qytetës të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja”, pas rreshtit **“Linja nr.13 Qyteti i Studentit”** shtohet togfjalëshi **“Linja nr.14 Qendër – Qendra Kristal – Qendër”**.
2. Në pikën 2 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, menjëherë pas rreshtit **“Stacioni Nr.10 – Rezervuarët e Ujit”**, tek paragrafi i fundit i **“Linjës nr.13 Qyteti Studenti”**, shtohen paragrafët si më poshtë:

Linja nr. 14 “Qendër – Qendra Kristal – Qendër”, me këtë intenerar:

Fillon në Qendër në afërsi të lulishtes tek Banka e Shqipërisë (stacioni i nisjes), kalon në rrugën “Ibrahim Rugova” deri në kryqëzimin me bulevardin “Gjergj Fishta” dhe vazhdon në rrugën “Sami Frashëri” deri në kryqëzimin me rrugën “Sulejman Delvina”, vazhdon përgjatë kësaj rruge

deri në kryqëzimin me rrugën “Medar Shtylla” dhe ndalon tek Qendra “Kristal” në rrugën “Prokop Mima” (stacioni i fundit).

Kthimi është në rrugën “Prokop Mima”, kthehet në rrugën “Medar Shtylla”, vazhdon në rrugën “Komuna e Parisit” deri në kryqëzimin me bulevardin “Bajram Curri”, kthehet në rrugën “Sami Frashëri” deri në kryqëzimin me rrugën “Myslym Shyri”, vazhdon deri në kryqëzimin me bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, vazhdon përgjatë bulevardit “Zog I” deri tek kryqëzimi i tij me rrugën “Ded Gjo Luli” duke u pozicionuar në stacionin e nisjes.

Shërbimi i transportit qytetës në këtë linjë duhet të plotësojë këta tregues:

A. Frekuencat

Frekuenca për linjën	F = 7 min
Frekuenca e daljes nga stacioni i nisjes në qëndër:	F = 3 min
Numri i autobusëve në lëvizje:	Is = 8 bus
Numri i autobusëve në inventar për linjën:	I = 10 bus
Koha për një cikël nisje/mbërritje:	Tc = 36 min = 0.6 orë
Gjatësia e linjës:	7,3 km
Kapaciteti mbartës i autobusëve:	C = 40 vende (15 ndenjor dhe 25 në këmbë)

B. Oraret

1. Oraret për shërbimin e transportit në linjë do të jenë:

- Në periudhën **Prill – Tetor**, orari i shërbimit do të jetë nga ora **05:00** deri në orën **23:00** me frekuencën si më poshtë:

Nga ora 5:00 deri në ora 6:00, frekuenca do të jetë	15 minuta
Nga ora 6:00 deri në ora 7:00, frekuenca do të jetë	8 minuta
Nga ora 7:00 deri në ora 20:00, frekuenca do të jetë	7 minuta
Nga ora 20:00 deri në ora 22:00, frekuenca do të jetë	10 minuta
Nga ora 22:00 deri në ora 23:00, frekuenca do të jetë	12 minuta

Stacioni i fillimit: Qendër, në afërsi të Bankës së Shqipërisë në ora **5:00**
Stacioni fundit: Qendra “Kristal” ora **22.30** niset autobusi i fundit.

- Në periudhën **Nëntor – Mars**, orari i shërbimit do të jetë nga ora **05.30** deri në orën **23.00** me frekuencën si më poshtë:

Nga ora 5:30 deri në ora 7:00, frekuenca do të jetë	9 minuta
Nga ora 7:00 deri në ora 20:00, frekuenca do të jetë	7 minuta
Nga ora 20:00 deri në ora 21:30, frekuenca do të jetë	10 minuta
Nga ora 21:30 deri në ora 23:00, frekuenca do të jetë	12 minuta

Stacioni i fillimit: Qendër, në afërsi të Bankës së Shqipërisë në ora **5:30**
Stacioni fundit: Qendra “Kristal” ora **22.30** niset autobusi i fundit.

- Në ditë të diele dhe festa zyrtare, orari i shërbimit do të jetë nga ora **06.00** deri në orën **22.00** me frekuencën si më poshtë:

Nga ora 6:00 deri në ora 9:00, frekuenca do të jetë	15 minuta
Nga ora 9:00 deri në ora 20:00, frekuenca do të jetë	10 minuta
Nga ora 20:00 deri në ora 22:00, frekuenca do të jetë	15 minuta

Stacioni i fillimit: Qendër, në afërsi të Bankës së Shqipërisë në ora **6:00**
 Stacioni fundit: Qendra “Kristal” ora **21.30** niset autobusi i fundit.

Kohë qëndrimi në stacionet ndërmjetëse: 30 sekonda.

C. Kushtet që duhet të plotësojë secili autobus i linjës:

1. Për automjetet e reja nuk është kusht që duhet të jenë të prodhuara vetëm në vendet e Bashkimit Europian.
2. 100 % e mjeteve të inventarit do të jenë të pajisura me kondicionim.
3. Estetika e jashtme e mjeteve do të jetë 100 %.
4. Estetika e brendshme e mjeteve do të jetë 100 %.
5. 100 % e totalit të inventarit të mjeteve, do të jenë të pajisura me pajisje të veçanta për invalidët.

D. Stacionet e ndalimit

1. Stacionet e ndalimit të autobusit për linjën do të jenë:
 Stacioni Nr.1 – Qendër (Banka e Shqipërisë).
 Stacioni Nr.2 – Kryqëzimi i rrugës “Ibrahim Rugova” me bulevardin “Gjergj Fishta”.
 Stacioni Nr.3 – Në rrugën “Sami Frashëri”, përballë piceri “Juvenilja”.
 Stacioni Nr.4 – Tek sheshi “Willson”.
 Stacioni Nr.5 – Në rrugën “Medar Shtylla”, në afërsi të kryqëzimit me rrugën “Sulejman Delvina”.
 Stacioni Nr.6 – Në rrugën “Medar Shtylla”, përballë UNYT.
 Stacioni Nr.7 – Tek Qendra “Kristal”.

Në kthim:

- Stacioni Nr.8 – Në rrugën “Medar Shtylla”, përballë UNYT.
 - Stacioni Nr.9 – Kryqëzimi i rrugës “Medar Shtylla” me rrugën “Skënder Luarasi”.
 - Stacioni Nr.10 – Në rrugën “Komuna e Parisit”.
 - Stacioni Nr.11 – Në bulevardin “Bajram Curri”, përballë ish ekspozitës “Shqipëria Sot”.
 - Stacioni Nr.12 – Në rrugën “Myslym Shyri”, pranë Drejtorisë së Policisë.
 - Stacioni Nr.13 – Në rrugën “Myslym Shyri”, tek Lulishtja “Parku Rinia”.
 - Stacioni Nr.14 – Tek hotel “Tirana International (15 Katëshi)”
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve (Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë), Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (QLT), Drejtoria e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Agjensia për Mbrojtjen e Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI